



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 13 prot

Tepelenë, më 22.12. 2025

PROCES-VERBAL
(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot, më datë 22.12.2025, ora 11:00 në Pallatin e Kultures (kati II dytë) në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 25.11.2025.
3. **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Nëntor 2025.”
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Nëntor 2025.”
5. **Projektvendim:** “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028.”
6. **Projektvendim:** “Për miratimin e buxhetit për vitin 2026”
7. **Projektvendim:** “Për miratimin e bursave për nxënës të arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2025-2026.”
8. Çështje të tjera
9. Kërkesa ankesa të qytetarëve

Kryetari i Këshillit Bashkiak, Z. Arben Gumeni, drejton mbledhjen. Ora e hapjes së mbledhjes: 11:00.

Këshilltarët pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Mjaftoni Zeraç, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Vladimir Bakiaj, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Dino Selimi, Ilir Haska.

Prezent nga Administrata e Bashkisë: Kryetari Bashkisë Z.Gramos Sako, N/Kryetar z.Spiro Kora, N/Kryetar znj.Julinda Karteri, Arta Shaha, Adi Velaj, Gezim Shehu, Ervin Panidha, Florenc Korca Armand Sala, Festime Elezi

Kryetari i Këshillit, Z. Arben Gumeni, deklaroi hapjen e mbledhjes dhe paraqet rendin e ditës,
Jeni dakort me rendin e ditës?

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Votimi: Vota Pro (11): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Mjaftoni Zera, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Vladimir Bakiaj, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Dino Selimi, Ilir Haska.

Vota Kundër: S'ka.

Vota Abstenim: S'ka.

Projektvendim: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 25.11.2025.

Kryetari i Këshillit drejton pyetje lidhur me procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Votimi: Vota Pro (11): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Mjaftoni Zera, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Vladimir Bakiaj, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Dino Selimi, Ilir Haska.

Vota Kundër: S'ka.

Vota Abstenim: S'ka.

Projektvendim: Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Nentor 2025.

Kryetari i Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetar i Komisionit të Ekonomisë, Kjo pike e rendit të ditës nuk ka ndryshim nga muaji I kaluar trajtohen me f ndihmës ekonomike me fond 6%, 11 familje me fond 46,036 lekë.

- Njësia Qytet: 7 familje
- Njësia Kurvelesh: 1 familje
- Njësia Lopës: 1 familje
- Njësia Qëndër: 2 familje

Kryetari i Këshillit ka pyetje /JO

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit.

Votimi: Vota Pro (11): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Mjaftoni Zera, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Vladimir Bakiaj, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Dino Selimi, Ilir Haska.

Vota Kundër: S'ka. Vota Abstenim: S'ka.

Arben; Tek ceshtje të tjera ka ardhur një pvendim nga administrata, Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025, me të cilin jeni njohur, jeni dakort ta diskurojme tek ceshtje te tjera, po

Projektvendim: Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Nëntor 2025.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit të Ekonomisë, Për muajin Nëntor trajtohen me ndihme ekonomike fondi I bashkise 92 familje me fond 235.178 lekë, ka nje shtese njësia Qendër

Njësia Qëndër: 53 familje

Njësia Qytet: 35 familje

Njësia Kurvelesh: 2 familje

Njësia Lopës: 2 familje

Ka pyetje? jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit.

Votimi: Vota Pro (11): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Vladimir Bakiaj, Miftar Meta, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Matilda Çela. Dino Selimi. Ilir Haska.. Vota Kundër: S'ka. Vota Abstenim: S'ka.

Projektvendim: “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028.”

Kryetari Keshillit z. Arben; Fjalën e ka Kryetari i Bashkisë, z. Gramos Sako.

Të nderuar këshilltarë, të nderuar përfaqësues të administratës, Ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë mbledhje, ku sot do të shqyrtojmë dhe diskutojmë Programin Buxhetor Afatmesëm 2026–2028, si dhe Buxhetin e vitit 2026, dokumente të rëndësishme për planifikimin strategjik dhe menaxhimin financiar të Bashkisë.

Programi Buxhetor Afatmesëm 2026–2028 është hartuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe udhëzimet përkatëse, duke u mbështetur në një analizë reale të kapaciteteve financiare dhe nevojave të Bashkisë. Ky program synon të garantojë vazhdimësinë e shërbimeve publike, stabilitetin financiar, si dhe planifikimin e qëndrueshëm të investimeve në vitet në vijim.

Buxheti i vitit 2026 reflekton prioritetet kryesore të bashkisë, me fokus në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës, mbështetjen e arsimit dhe të shërbimeve sociale, si dhe përdorimin e përgjegjshëm dhe eficient të fondeve publike.

Gjatë procesit të hartimit janë zhvilluar konsultime publike, me qëllim që planifikimi buxhetor të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe transparent, duke reflektuar, në masën më të madhe të mundshme, nevojat dhe prioritetet e komunitetit në njësitë administrative.

Në këtë material është reflektuar gjithçka që është diskutuar gjatë dëgjësive publike në njësitë administrative, ndërkohë që angazhimi ynë mbetet për të bërë edhe më shumë në funksion të përmirësimit të shërbimeve dhe zhvillimit vendor.

Ky proces kërkon bashkëpunim institucional dhe diskutim konstruktiv, në mënyrë që vendimet që do të merren të jenë në shërbim të interesit publik dhe të zhvillimit afatgjatë të Bashkisë.

Për një paraqitje më të detajuar të të dhënave financiare dhe strukturës së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028 dhe Buxhetit të vitit 2026, ia kaloj fjalën Drejtorit të Financës.

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. Spiro Kora, i cili relatoi relacionin mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2026– 2028.(bashkelidhur relacioni)

Kryetari i Këshillit; ka pyetje

Vladimir Bakiaj: Këto shpenzime, te shkolla 9-vjeçare “Avni Rustemi”, pse bëhet fjalë për mbikëqyrje? Gjithashtu, te pika 13, blerje mjete transporti, ne kemi nevojë për mjete urbane, pasi makina e mbetjeve urbane paraqet problematikë. Çfarë është bërë me kaq pak fonde? A kanë ardhur mjetet e transportit?

Spiro: Zëri mbikëqyrje lidhet me likuidimin e pagesës për shkollën 9-vjeçare “Avni Rustemi”. Nuk është realizuar detyrimi ynë sipas kontratës, pasi pagesa për mbikëqyrjen është parashikuar të likuidohet në buxhetin e vitit 2026.

Vladimir Bakiaj: A është marrë në dorëzim shkolla?

Spiro:Kjo çështje ka të bëjë vetëm me ekzekutimin e pagesës. Mbikëqyrësi i ka përmbushur detyrimet kontraktuale; ka mbetur vetëm likuidimi nga ana jonë.

Vladimir Bakiaj: Në mbledhjen e kaluar të Këshillit kishte një ankesë nga një këshilltar, i cili kërkoi informacion lidhur me disa problematika në shkollën 9-vjeçare “Avni Rustemi”, por nuk u dha përgjigje.

Spiro:Në mbledhjen e radhës do të paraqitet informacion i plotë mbi konkluzionet e mbikëqyrësit dhe të kolaudatorit, si dhe me grupin e punës të bashkise të marrjes në dorëzim për zbatimin e kontratës rikostruksion shkolles.

Kryetari i Bashkisë, z. Gramos Sako: Shqetësimet lidhur me shkollën ia kemi bërë prezent zbatuesit të punimeve. Ne nuk ndërhyjmë, pasi objekti është në periudhë garancie.

Juli: Përveç 5% që mbahet si detyrim, duhet theksuar se projekti është bashkëfinancuar nga Bashkia Tepelenë dhe Ministria e Arsimit, pra bëhet fjalë për fonde të buxhetit të shtetit. Këto janë fonde që bashkia ka për t'i dhënë të shtrira në vite, si dhe ekziston garancia e punimeve dhe detyrimet përkatëse që duhet t'i shlyejë.

Kryetari i Bashkisë, z. Gramos Sako, Do të ketë ndërhyrje, pasi rrezikohet jeta e fëmijëve.

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. Spiro Kora, Te pika e dytë e relacionit, sipas tabelave, blerja e mjeteve të transportit e parashikuar në vitin 2025 lidhet me vlerën 4 milionë lekë. Këto mjete janë blerë, por pagesa nuk është ekzekutuar dhe është planifikuar të kryhet në katërmujorin e parë të vitit 2026. Ndërkohë, blerja e mjeteve të reja është parashikuar për vitet 2027–2028.

Arben: A ka pyetje? Jo Materiali hidhet në votim

Votimi: Vota Pro (11): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Vladimir Bakiaj, Miftar Meta, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Matilda Çela. Dino Selimi. Ilir Haska.

Vota Kundër: S'ka. Vota Abstenim: S'ka.

Pika e gjashtë e rendit të dities: “Për miratimin e Buxhetit për vitin 2026.”

Spiro: Relaton materialin bashkelidhur: “Për miratimin e buxhetit për vitin 2026”.

Ditar: Para dy mbledhjesh të këshillit kam kërkuar përfshirjen e një personeli mjekësor në strukturën e Bashkisë. A është planifikuar kjo?

Spiro: Numri i punonjësve për vitin 2026 është 240, si dhe 10 punonjës me kontratë, të përfshirë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetit të miratuar. Brenda këtij kufiri do të kontraktohen, me kohë të pjesshme, punonjës të kualifikuar, si inxhinierë, juristë, mjekë, teknikë ndërtimi, marangozë etj. sipas nevojave të Bashkisë.

Ditar: Me kontratë?

Spiro : Po.

Ditar: Shërbimi i higjienës është shërbim non-stop dhe nevojitet një personel mjekësor për të kontrolluar hedhjen e klorit në kazanët e mbeturinave, kryerjen e analizave të ujit etj. Ky personel nuk duhet të jetë me kontratë, por me emërim të plotë.

Vladimir Bakiaj; Gjatë këtij viti janë shtuar dy punonjës nëse kishte mundësi që të përfshihej edhe një punonjës tjetër.

Spiro; Numri që miratohet sot është numri maksimal i punonjësve.

Vladimir Bakiaj; Ka problematika kur në Këshill paraqiten materiale nga ana mjekësore për shqyrtimin e diagnozave, të cilat nuk mund të vlerësohen nga këshilltarët pa mbështetje profesionale, duke theksuar nevojën për staf mjekësor.

Ditar; Është e domosdoshme të ketë personel mjekësor.

Latif; Nuk është i nevojshëm një mjek me kohë të plotë.

Arben; Analizat e ujit kryhen çdo ditë.

Ditar; Nevojitet personel që t'i ndjekë këto procese.

Arben; Nuk do të bëhen ndërhyrje paralele.

Kryetari i Bashkisë; Për çfarë duhet të kete një mjek?

Vladimir Bakiaj; Nevoja për personel mjekësor lidhet me Bashkinë, për të diskutuar dhe trajtuar problematikat që paraqiten në lidhje me çështje shëndetësore.

Arben; Ka raport mjekësor nga komisioni, ka çështje për diskutim që lidhen me buxhetin?

Ditar; Ju shtoni numri i punonjësve me kontratë, duke shtuar personal shëndetësor.

Matilda : Pika e fundit, projekti “Nuk jemi vetëm”, çfarë u bë në vitin 2025, sepse është i njëjti projekt? Projekti “Qendër për shërbime komunitare për fëmijet me aftësi ndryshe”, nga informacioni që kam qendra deri në muajin qershor ka qenë e hapur. Çfarë u bë? Ne bashkëfinancojme por informacion nuk kemi. Tek materialet që kam para mungon tek adresa e email-it, ngritja e funksionimit të fondit social vendor për ofrimin e shërbimeve sociale në kodin e posatshëm V043A në shumën 2.000.000 lekë. Çfarë votojmë?

Spiro : Dy të parat nuk shprehen në Vendimin e Këshillit Bashkiak për shkak se janë sintetizuar tek pika që ju lexuat më lart, ngritja e funksionimit të Fondit Social Vendor, ky fond do të ketë kod thesari të posatshëm në vlerën 2 milion leke. Kjo për rritje të transparenës dhe disiplinimit të shpenzimeve për shërbimet sociale. Në këtë bashkefinancim të bashkisë do të vine të gjitha transfertat qeveritare për projektet të cilat do të fitojne dhe për të cilat kemi aplikuar, dhe shpresojme të fitojme 3 projekte që do të jenë pjesë e këtij programi. Pra, dy shërbimet sociale që bashkia do të financoje do të jenë me këtë kod projekti.

Matilda: Dy projektet e para që janë këtu apo janë vec?

Spiro: Do të jetë vetëm ky kod projekti brenda fondit 2 milion. Për fushën sociale do të funksinojë vetëm ky kod projekti.

Ditar: Ka projekte?

Spiro: Ne kemi aplikuar në 3 projekte.

Ditar : Cilat janë projektet?

Arta : Ne vitin 2025 është përfunduar projekti Qendër komunitare për aftësi ndryshe në muajin Qershor të vitit 2025 i cili ishte bashkëfinancim me PNUD. Për sivjet kemi planifikuar këtë mbështetje financiare nga ana e bashkisë. Pjesën tjetër kur të hapen thirrjet ne lekët i kemi, duhet të jenë të kodifikuara në atë grup-artikull që thotë Spirua, sepse nuk mund të bënim me ndryshime në buxhet.

Ditar : Projekti ka mbaruar në Qershor. Gjeni mundësinë të punoni non-stop për ata femijë.

Dino : Mund të funksionojë dhe 2 herë në javë. Ne nuk e hapim dot ne Tepelenë.

Matilda : Ky fond 927 i bashkëlidhet fondit 2 milion lekë?

Spiro : I bashkëlidhet. Në qoftë se ne, me 3 aplikimet që kemi bërë për projektet sociale nuk do të fitojmë, atëherë ne do të vijmë përsëri tek ju për të mar autorizimin që këto 2 milione leke t'i shperndajmë në këto 3 projekte.

Julinda : Edhe po fituam do të vijmë përsëri në këshill, sepse duhet të marrin miratimin tuaj për ndarjen e parave.

Matilda : Në qoftë se nuk do të ishte e mundur të arrihej që këta specialist, mësues/ndihmës të ishin ketu, do të ishte e mira që këtyre familjeve t'u ofrohej shërbimi i transportit, për në Gjirokastrë.

Ditar : Dhe mundësia e transportit është mundësi e mire.

Arben : Ka pyetje të tjera në lidhje me buxhetin? Hidhet në votim.

Votimi: Vota Pro (11): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Vladimir Bakiaj, Miftar Meta, Mjaftoni Zeraaj, Ditar Hodaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Matilda Çela. Dino Selimi. Ilir Haska..Vota Kundër: S'ka.Vota Abstenim: S'ka.

Pika 7 e Rendit te Dites “Për miratimin e bursave për nxënës të arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2025-2026.”

Besnik : Komisioni i Arsimit u mbledh në datën 18.12.2025, shqyrtoji materialin, janë 7 bursa për arsimin profesional dhe 15 bursa për arsimin e mesëm.

Arben : Ka pyetje?

Matilda : Të kishte më shumë bursa. Sa kërkesa ka patur për klasen e 10-te dhe sa janë realizuar?

Arta : Të gjitha janë realizuar përveç të fshatit Dhemblan.

Matilda : Kërkesat e Njesisë Administrative Lopës për bursa u futen në nismën e Këshillit Bashkiak Tepelenë.

Arben : Hidhet në votim.

Votimi: Vota Pro (11): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Vladimir Bakiaj, Miftar Meta, Mjaftoni Zeraç, Ditar Hodaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Matilda Çela. Dino Selimi. Ilir Haska. Vota Kundër: S’ka. Vota Abstenim: S’ka.

Kemi materialin e ardhur nga aparati i bashkise për një shtese ne buxhetin e vitit 2025.

Spiro : Këshilli i Ministrave ka bërë një ndryshim në buxhetin e vitit 2025. Një nga përfituesit është edhe Bashkia jone në vlerën 9.124.000 lekë. Kjo vlerë do përdoret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të vitit të kaluar.

Arben : Hidhet në votim.

Votimi: Vota Pro (11): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Vladimir Bakiaj, Miftar Meta, Mjaftoni Zeraç, Ditar Hodaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Matilda Çela. Dino Selimi. Ilir Haska. Vota Kundër: S’ka. Vota Abstenim: S’ka.

KËRKESA DHE ANKESAT E QYTETARËVE

Kërkesa nga Znj. Arta Seferi banuese ne qytetin Tepelene (bashkelidhur kërkesa). Problematik lageshtia në shtëpi.

Dino : Ka 5 vjet. Cfarë është bërë për këtë problematike?

Arben : Kjo kërkesë t’i kaloj për shqyrtim bashkisë.

Vladimir Bakiaj : Ka problematika, kjo shtëpi është pa leje, për shkak të rrugës nuk është legalizuar. Asaj t'i blej një shtëpi te re bashkia. Të zgjidhet ky problem.

Dino:. Aty kalojnë mjete të tonazhit të lart.

Arben : Ajo ka shume problematika. Bashkia të ngrej komision për zgjidhjen e problematikës.

Ditar : E zgjidhim dot ne këtë problem, ka ardhur disa here në keshill. T'ja kalojmë administratës.

Latif : Nga bashkia nuk na është kthyer përgjigje për kërkesat e qytetarëve.

Matilda : Bashkia të kthej përgjigje për cdo kërkesë.

Dino : Ankesa e fshatit Salari nuk është kthyer përgjigje. Ne të zgjidhim problemet e qytetarëve. Problematika e fshatit Salari të zgjidhet.

Leonidha : Shqetësimet nga keshilli janë zgjidhur. Rruga në Salari e hapur, kemi kthyer përgjigje, kërkohet përmiresim i rrugës dhe pastrimi i saj.

Kryetari i Bashkisë z.Gramos Sako : Ka pasur problematik, kemi sqaruar personat, ka disa VKB që nuk janë zbatuar për hapje ruge.

Spiro: Problemi i Arta Seferit është trajtuar, kemi ndërhyr me bazë materiale, zona është e paurbanizuar.

Julinda: Problematike ujërat e zeza, pozicioni jo i favorshëm. Duhet të trajtohet me grope septike, lagështia vjen nga kjo gje. Në mënyre periodike është ndihmuar.

Vladimir Bakiaj : Cfare zgjidhje do jepet?

Ditar : Mund t'i afrohet bonus qiraje të iki nga shtëpia.

Julinda: Ja kemi ofruar bonusin e qirasë.

2. Kërkesë nga Z. Artur Maca banor i fshatit Benc (bashkëlidhur kërkesa) të cilit i kanë ngordhur dy mushka. Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë.

3. Kërkesë nga Z. Hasan Hoxha banues i fshatit Becisht, kërkon ndihmë financiare për djegie banese. Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë.

4. Kërkesë nga Z. Fejzi Xheza banor i qytetit Tepelenë, i cili kërkon ndihmë financiare për riparim catie. Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë.

5. Kërkesë nga Z. Sadik Varfi banor i fshatit Dukaj, i cili kërkon ndihmë financiare për arsye shëndetësore. Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë.

6. Kërkesë nga Z. Pellumb Dalani banor i Bashkisë Tepelenë, i cili kërkon ndihmë financiare për rikonstrukcion catie. Kjo kërkesë ti delegohet Bashkisë, zyra përkatëse.

7. Kërkesë nga z. Luan Meta Kryetar i fshatit Gusmar, i cili për arsye personale kërkon dorëheqjen nga kjo detyrë.

Mbyllet mbledhja e këshillit në orën 12:25.

SEKRETARE E KËSHILLIT

Valbona ÇELA



KRYETAR I KËSHILLIT

Arben GUMENI

